

## KUSHTET E PËRDORIMIT TË SHËRBIMIT “ALPHA SMS”

“Alpha Bank Albania” SHA ofron për klientët e saj shërbimin “**Alpha SMS**”, i cili është një shërbim informues nëpërmjet mesazheve (SMS) në lidhje me transaksionet e kryera nga klienti, shkurtimisht “Shërbimi” në përputhje me këto kushte të përdorimit

### 1. Legjenda

“**Banka**”, është “Alpha Bank Albania” SHA dhe gjithë rrjeti i degëve dhe përfaqësuesit e saj.

“**Karta**”, është karta/t plastike e Debitit ose e Kreditit që lëshohen nga Banka.

“**Llogaria rrjedhëse**”, është llogaria e çelur në Bankë nga klienti në monedhën e përzgjedhur prej tij, e cila lidhet me “Kartën”.

“**Klienti**”, është **përdoruesi i shërbimit**, mbajtës i një llogarie rrjedhëse, i cili pranon kushtet e shërbimit.

“**Kushtet e shërbimit**”, janë informacioni i përgjithshëm mbi të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta për ofrimin dhe pranimin e shërbimit “Alpha SMS”.

“**Transaksion**”, është çdo veprim kreditimi dhe/ose debitimi në llogarinë rrjedhëse dhe/ose me Kartë.

“**Pikë e shitjes elektronike**”, shkurt “EPOS”, është pajisja që bën të mundur përdorimin e Kartës në një pikë shitje të tregtarit.

“**POS Virtual**”, janë pikat e shitjes virtuale në faqet e internetit, ku kartat nuk janë prezente në pajisje, të cilat përdoren nga Tregtarët për autorizimin e transaksioneve.

“**ATM**”, është terminali elektronik që i lejon klientit të kryejë tërheqje, depozitime ose veprime të tjera të lejueshme me kartën.

“**Tregtari**” ose “**Pranuesi i kartës**”, është çdo njësi ekonomike që pranon Kartën si mjet pagese për blerje mallrash ose kryerje shërbimesh dhe përdor një terminal “**EPOS/POS Virtual**”.

“**Udhëzimet e Përdorimit**” janë udhëzime nga Banka të cilat drejtojnë operacionet dhe përdorimin e shërbimit “Alpha SMS” dhe do t’i njoftohen klientit me anë të çdo mjeti sa herë ka përditësime (telefon, fax, e-mail, adresë zyrtare të Bankës, postë rekomandë)

“**Komisioni mujor**” është një tarifë administrative që paguhet për mirëmbajtjen e këtij Shërbimi në përputhje me librin e tarifave, komisioneve dhe shpenzimeve të publikuara nga Banka.

“**Të dhënat personale**” kanë të njëjtin kuptim si ai i përdorur në Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

### 2. Objekti i shërbimit

2.1. Shërbimi “Alpha SMS” ka për objekt dhënien, në kohë reale, të informacionit për çdo transaksion të kryer prej Klientit në përputhje me kushtet e pranuar të Shërbimit si dhe të balancës në llogarinë rrjedhëse pas kryerjes së transaksionit.

2.2. Transaksionet që përfshihen në këtë shërbim janë:

2.2.1. Blerjet në EPOS dhe POS virtual në Shqipëri dhe jashtë vendit;

2.2.2. Rimbursimet si pasojë e transaksioneve të pershkrjuara në pikën 2.2.1;

2.2.3. Tërheqjet nga “ATM”-të në Shqipëri dhe jashtë vendit, me një vlerë dysheme sipas përcaktimit të klientit, por jo më pak se 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) Lekë.

2.2.4. Veprimet debitore dhe/ose kreditore me një vlerë mbi 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) Lekë të kryera në llogarinë rrjedhëse të lidhur me kartën e debitit të regjistruar në këtë platformë.

2.2.4.1. Kur klienti është regjistruar më parë në degë për marrjen e shërbimit SMS në nivel llogarie, vlera dysheme e zgjedhur nga klienti në formularin e aplikimit do të mbizotërojë mbi vlerën dysheme të përcaktuar në pikën 2.2.4 të këtyre Kushteve të Shërbimit.

2.2.4.2. Klienti që dëshiron të përcaktojë një vlerë të ndryshme dysheme për njoftimin për veprimet sipas pikës 2.2.4 të këtyre Kushteve të Shërbimit, mund të paraqitet në cdo Degë të Alpha Bank Albania për të kërkuar këtë ndryshim.

### 3. Regjistrimi dhe aktivizimi i shërbimit

3.1 Regjistrimi në shërbimin “Alpha SMS”, kryhet përmes platformës digjitale, e cila gjendet në adresën zyrtare të bankës [www.alphabank.al](http://www.alphabank.al), me kusht që klienti të vetë-regjistrohet në përputhje me Udhëzimet e përdorimit ose në degët e Alpha Bank Albania SHA, duke plotësuar formularin përkatës “Alpha E-Banking” - “Alpha SMS”.

3.2 Për të përfutur nga ky shërbim, klienti duhet të regjistrojë në platformën digjitale të dhënat e tij personale dhe detajet e Kartës së tij.

3.3 Banka rezervon të drejtën për të refuzuar kërkesën e Klientit për t’u regjistruar në shërbimin “Alpha SMS”, në rast se informacioni i dhënë në lidhje me të dhënat e tij personale dhe detajet e Kartës nuk është në përputhje me ato të deklaruara nga klienti në bankë.

3.4 Gjatë regjistrimit, Klienti detyrohet t’i sigurojë Bankës një numër telefoni celular, ku do të dërgohen mesazhet me tekst njoftimi (SMS), si dhe një adresë e-mail. Në rast se Klienti dëshiron të regjistrojë në platformën digjitale më shumë se një kartë, ai mund të deklarojë për çdo kartë numrat të tjerë telefoni celular.

3.5 Pas përfundimit të regjistrimit, Klienti duhet të kryej aktivizimin e shërbimit duke ndjekur udhëzimet e përdorimit.

**3.6** Duke u regjistruar në portal mbajtësi i kartës jep pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave personale sipas ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar; sipas autorizimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale apo dispozitave ligjore në fuqi.

#### **4. Funksionaliteti i shërbimit**

- 4.1.** Pas regjistrimit dhe aktivizimit të shërbimit "Alpha SMS", Klienti do të marrë njoftime në numrin e telefonit celular të regjistruar, përmes mesazheve tekst mbi transaksionet e suksesshme të përmendura në pikën 2.2., sipas përzgjedhjes së tij.
- 4.2.** Mesazhi me tekst (SMS) dërgohet në kohë reale në numrin e telefonit celular të Klientit pas miratimit të transaksionit të kryer, duke përfshirë informacionin për llojin e transaksionit, emrin e tregtarit ose "ATM" ku transaksioni është kryer, datën, kohën e saktë të pagesës, shumën dhe monedhën e transaksionit.
- 4.3.** Klienti mund të zgjedhë gjuhën shqip ose anglisht si gjuhë të mesazhit tekst. Kjo mundësi mund të ndryshohet në çdo kohë përmes platformës digjitale "Alpha SMS" ose duke telefonuar Shërbimin e Klientit të Bankës.
- 4.4.** Çdo mesazh dërgohet automatikisht; prandaj Klienti nuk mund t'i përgjigjet mesazhit të dërguar.
- 4.5.** Mesazhi i transaksionit të kryer me kartë dërgohet vetëm një herë dhe nuk mund të riprodhohet.
- 4.6.** Klienti mundet, në çdo kohë, të kërkojë revokimin e shërbimit "Alpha SMS", duke plotësuar dhe nënshkruar formularin përkatës në degët e Bankës ose në platformën digjitale "Alpha SMS".
- 4.7.** Klienti mund të modifikojë në çdo kohë numrin e telefonit dhe adresën e-mail në platformën "Alpha SMS" (shih më posht paragrafin 5.1). Megjithatë, modifikimi i këtyre të dhënave nuk ndikon në të dhënat e tyre të regjistruara për produktet ose shërbimet e tjera bankare që ai mund të ketë në bankë.

#### **5. Të drejtat dhe detyrimet e Klientit**

- 5.1.** Klienti ka të drejtat si më poshtë:
  - i. të shtojë në çdo kohë, kartë/at shtesë në shërbim;
  - ii. të ndërpresë në çdo kohë shërbimin, për një apo më shumë karta;
  - iii. të ndryshojë numrin e telefonit celular dhe/ose adresën e-mail. Nëse Klienti ka regjistruar në platformë më shumë se një kartë, atëherë ndryshimi nuk ndikon në pjesën tjetër të të dhënave që janë regjistruar në këtë shërbim;
  - iv. të përzgjedh transaksionet që do të përfshihen në dhënien e këtij shërbimi, sipas percaktimeve të pikës 2.2.
- 5.2.** Klienti është i detyruar të kontrollojë saktësinë e informacionit që Banka i njofton me SMS dhe në rast se nuk njih ndonjë transaksion, ai duhet të informojë menjëherë Bankën duke dërguar email në adresën: [callcenter.albania@alpha.gr](mailto:callcenter.albania@alpha.gr) ose duke telefonuar në numrin: +35542240477.
- 5.3.** Klienti ka të drejtën e qasjes në të dhënat e tij personale të regjistruara në Alpha Bank Albania SHA në cdo moment si dhe të drejtë për ti korrigjuar ato duke u paraqitur në një nga degët e Bankës.

#### **6. Detyrimet dhe përgjegjësia e Bankës**

- 6.1** Banka nuk mban përgjegjësi, në rast se sistemet ose arkivat e Klientit infektohen nga një virus, dhe në asnjë moment nuk kryhen kontrole përkundrejt tyre.
- 6.2** Banka mban përgjegjësi për debitimin e komisionit mujor të Shërbimit sipas pikës 7.1 të këtyre kushteve;
- 6.3** Banka nuk mban përgjegjësi në lidhje me ndonjë vonesë të mesazheve informative të pasuksesshme apo jo në kohë reale, për shkak të arsyeve që i atribuohen ose që lidhen me ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit të mbajtësit të kartës apo faktorëve të tjerë, të cilat janë përtej kontrollit të Bankës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në , rastet e mëposhtme: a) mungesa e mbulimit të telefonisë celulare në zona të caktuara, b) mesazhe hyrëse që tejkalojnë kapacitetin e pajisjes së mbajtësit të kartës, c) mirëmbajtjen e rrjetit të telekomunikacionit, d) telefoni celular ose papajtueshmëria e Shërbimit etj.
- 6.4** Banka nuk mban asnjë përgjegjësi për përdorimin e paautorizuar të kartës apo për ndonjë faturë të paplotë/jo të saktë ose informacion të vonuar si pasojë e detyrimit nga tregtari ku është kryer transaksioni apo ndonjë institucion kreditor me të cilin bashkëpunon dhe është përgjegjës për transaksionin e të dhënave.
- 6.5** Banka nuk mban asnjë përgjegjësi për pagesat që mund të vendosen nga ofruesi i telekomunikacionit të mbajtësit të kartës.

#### **7. Komisioni i shërbimit**

**7.1.1** Për ofrimin e këtij shërbimi do të gjejnë aplikim komisionet si më poshtë:

- 7.1.1.1** Për njoftimet e transaksioneve të kryera me kartën/at e debitit si dhe për çdo transaksion të kryer në llogarinë e lidhur me kartën/at e debitit, komisioni është 100 Lekë në muaj, i cili do të debitohet automatikisht në llogarinë rrjedhëse të lidhur me kartën/at e debitit për të cilat ofrohet ky shërbim.



**Shembull:** nëse Klienti ka me shumë se një kartë debiti të lidhur me llogarinë rrjedhëse komisioni i aplikueshëm do të jetë 100 Lekë në muaj pavarësisht numrit të kartave të debitit të lidhura në platformën digjitale. Nëse kartat e debitit të regjistruara do të jenë të lidhura me llogari rrjedhëse të ndryshme atëherë Klientit do të paguaj komision 100 Lekë në muaj për çdo llogari.

7.1.2. Për njoftimet e transaksioneve të kryera me kartën/at e kreditit, komisioni është 100 Lekë në muaj për secilën kartë krediti për të cilën ofrohet ky shërbim dhe do të debitohet automatikisht çdo datë 1 të muajit pasardhës në limitin e kartës së kreditit.

**7.2** Komisioni(et) e shënuara në këto Kushte mund të jenë subjekt ndryshimi nga ana e Bankës. Për çdo ndryshim, Banka do të njoftojë mbajtësin e kartës së regjistruar në platformë të paktën 15 ditë kalendarike para hyrjes në fuqi të ndryshimit.

## **8. Çrregjistrimi dhe Përfundimi**

**8.1.** Klienti, në çdo kohë, mund të çregjistroj kartën e tij nga shërbimi pa asnjë kosto shtesë, përmes platformës digjitale apo përmes paraqitjes së tij në një nga degët e Bankës. Në rast të çrregjistrimit përmes platformës digjitale, Klienti është i detyruar të ndjekë Udhëzimet e Përdorimit.

**8.2.** Banka mund të modifikojë dhe/ose shfuqizojë këto "Kushte" dhe/ose ta ndërpresë vetë Shërbimin, në çdo kohë, duke njoftuar klientin të paktën 15 ditë kalendarike përpara se të shpall hyrjen në fuqi të modifikimit/shfuqizimit apo ndërprerjen e këtij Shërbimi.

## **9. Kushte të Përgjithshme**

**9.1.** Regjistrimi dhe aktivizimi në shërbimin "Alpha SMS" dhe përdorimi i tij nga Përdoruesi i shërbimit nënkupton pranimin e tij të pakushtëzuar të këtyre kushteve

**9.2.** Me pranimin e kushteve të mësipërme, klienti autorizon Bankën të përdorë numrin e telefonit të tij celular, të cilin e ka ofruar gjatë regjistrimit të tij në Shërbim, me qëllim të mbajtjes së tij të azhurnuar për çështjet që janë relevante për Shërbimin ose që kanë të bëjnë me bashkëpunimin me Bankën.

**9.3.** Kushtet e Përdorimit të Shërbimit Alpha SMS, janë subjekt rishikimi sipas vendimeve të Bankës, të publikuara në faqen dhe ambientet zyrtare të Bankës.

## **10. Ligji i aplikueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**9.1** Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

**9.2** Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt ato palet do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.